

Editorial

Ta mbajmë planifikimin në binarë

Shtatë **demo-projekte** janë përzgjedhur në komunat partnere të MuSPP-it. Kontributi në këtë buletin tregon se demo-projektet dhe veprimet e ardhshme në komuna janë ndërmarrë nga një mori e akterëve në të njëjtën kohë. Kjo veç se ka rezultuar me një numër të madh të projekteve dhe pjesëmarrësve të ri në zbatimin e tyre se sa është paraparë në fillim. Ne presim të nxjerrim mësimet nga iniciativat e demo-projekteve si dhe iu inkurajojmë juve gjithashtu të reflektoni në lidhje me këtë. Përfshirja e eksperiencave, mësimëve, rreziqeve si dhe kufizimet do të krijojnë një potencial të madh për të qenë strategjik në projektet për investime të mëdha kapitale si dhe arritjen e ndryshimeve të qëndrueshme.

Gjashtë **punëtori të vizionimit** të mbajtura në bashkëpunim me gjashtë komunat partnere kanë dëshmuar të kenë qenë një shtytje dhe mundësi për shoqërinë civile dhe planerët profesionistë të mendojnë më larg "jashtë kornizave", duke paraqitur deklaratat inspiruese të vizionit dhe dokumentat kualitative të vizionit të integruar të jenë pjesë e PZHK. Ne do të donim të kishim reflektimet tuaja për eksperiencën dhe rezultatet gjatë dhe pas ngjarjeve të vizionimit në mënyrë që t'i përkthejmë ato në praktika të mira dhe mësimet e nxjerra t'i paraqesim në "Fletushkën e ardhshme të vizionimit në Kosovë". Në këtë mënyrë mund të shkëmbehen mësimet me të gjitha komunat dhe institucionet në Kosovë (dhe më gjerë).

Më 1 Tetor **Dita Botërore e Habitat-it** (DBH) u festua në 4 komunat me moton e vitit: "Qyteti i sigurtë është qytet me drejtësi", ku morën pjesë me qindra pjesëmarrës përfshirë këtu qytetarë, profesionistë, zyrtarë të



komunave si dhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pjesëmarrës të SHPK dhe nga organizatat ndërkombëtare, akademikë...si dhe një pjesëmarrje e fuqishme e të rinjve të Kosovës. Për këtë ne vendosëm të botojmë një numër të veçantë të buletinit dedikuar ngjarjeve të krenimit të DBH-it. Një e veçantë është se kjo ditë koïncidon me ri-hapjen e linjës hekurudhore në mes të Prishtinës dhe Pejës. Kjo hap një dritare për mundësitë për zhvillime më të qëndrueshme në Kosovë.

"Zhvillimi i qëndrueshëm i planifikimit hapësinor dhe transportit" është një ombrellë që ngërthen organizimin e një seri konferencash mbi temat për ndërlidhjen në të vërtetë të transportit të qëndrueshëm dhe lëvizshmërisë me planifikimin hapësinor. Është hera e parë që kjo temë e rëndësishme diskutohet në Kosovë, dhe se një komision unik i nivelit të lartë në bashkëpunim me UN-HABITAT-in bën që kjo iniciativë të realizohet. Përderisa ky buletin po përfundon së përgatituri, konferenca e parë mbi transportin publik përfundon me sukses të madh. Iu jemi falënderues të gjithëve për pjesëmarrje dhe bashkëveprim dhe iu ftojme të merrni pjesë edhe në ligjeratën e veçantë në Nëntor 2007 si dhe

Planifikimi është padyshim në binarë me komunat partnere të MuSPP-it. Qeveritë komunale janë duke punuar në Planet Zhvillimore Komunale dhe Urbane. Cikli i konferencave po vë në binarë planifikimin ndër-sektoral në nivelin qendror. Puna e vështirë është një gjë, por dorëzimi i "të arriturave të vështira" është padyshim më e vështirë. Synimi për të arritur aprovimin e PZHK/PZHU-ve para fundit të këtij programi kërkon zotimin nga vendim-marrësit lokalë dhe drejtoritë e planifikimit si dhe një udhërrëfyes të qartë për Shqyrtimin Publik formal në një të ardhme të afërt. Ne jemi të lumtur që MuSPP vazhdon deri në Prill'08 duke dashur që të shohim fundim së bashku.

Zgjedhjet e ardhshme në Kosovë, si dhe negociatat mbi statusin do të jenë sfiduese për të gjithë akterët që **të mbajmë planifikimin në binarë**, politikisht dhe teknikisht. Por kur njëherë treni është kthyer në binarë, shoferi duhet të sigurojë arritjen e tij në kohë. Nëse jo, treni do të dështojë të tërheq klientët (e ri) dhe do të jetë jashtë servisit. Kjo nuk bën të ndodhë as me trenin e as me planifikimin në Kosovë.

Elisabeth Belpaire
KKT/Udhëheqëse e programit

PZHK DHE PZHU E GJAKOVËS NË SHQYRTIM PUBLIK

Si do të zhvillohet qyteti dhe komuna e Gjakovës në 10 vitet e ardhshme kjo tani do të varet edhe nga qytetarët.

Para se të finalizohen dhe dërgohen për aprovim në Kuvendin Komunal, Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Plani Zhvillimor Urban (PZHU) i Gjakovës u vunë në shqyrtim publik më 18 Shtator 2007. Kohëzgjatja e shqyrtimit publik, sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor është minimum 60 ditë për PZHK dhe 30 ditë për PZHU.

Shqyrtimi publik i të dy planeve ofron një mundësi për të gjithë qytetarët që të japin komentet dhe sygjerimet e tyre.

Mendimet e qytetarëve më tej do të analizohen nga autoritetet komunale përgjegjëse për çështjet urbane.

Jo të gjitha idetë e qytetarëve mund gjithnjë të mirren parasysh, andaj ekspertët e komunës do të përgatisin një raport i cili jep sqarimet mbi marrjen parasysh apo jo të ideve dhe propozimeve të qytetarëve të cilat janë dorëzuar gjatë procesit të shqyrtimit publik.

Planet janë të ekspozuara në sallën e takimeve në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim dhe planerët komunalë janë në dispozicion për t'iu ofruar qytetarëve sqarime të nevojshme rreth përbajtjes së planeve.



VËNIA E VIZIONIT NË VEPRIM

"Vënia e ideve në veprim" ishte motoja e Forumit Urban Botëror të fundit (Vancouver, 2006). Me një varg të Punëtorive për vizionim (shih buletin e fundit Fokus) ne jemi munduar që ta avancojmë bashkëprodhimin e vizioneve dhe ideve planifikuese të mira. Prej ëndërrave të largëta në masat e menjëherëshme për t'i përmirësuar kushtet jetësore të kosovarëve në gjashtë qytetet e rangut të dytë për nga madhësia. Këto vizione dhe ide duhet të shndërrohen në plane të mirëfillta për zhvillimin komunal dhe urban, të cilat janë duke u hartuar aktualisht (apo tashmë të miratuara si në rastin e Pejës). Për të dëshmuar se realizimi i vizioneve afatgjata mund të fillojë me veprime të vogla, ne i kemi nisur "projektet demonstruese" (demo projektet). Demo projektet janë projekte të vogla të cilat e paraqesin misionin e MUSPP, i cili është "vënia e ideve në veprim". Prandaj, demo projektet duhet të jenë të orientuara kah veprimet, me rezultate të prekshme, pothuaj të "dukshme", që duhet të arrihen para përfundimit të fazës së parë të MUSPP-it në prill të vitit 2007.

Në kuadër të programit të tij 2005-2008, të financuar nga Sida, MUSPP posedon një buxhet të vogël prej 100,000 USD për t'i bashkëfinancuar demo projektet. Meqë MUSPP është aktiv në pesë komuna plus në pjesët jugore dhe veriore të Mitrovicës, ai e ka për qëllim që të ketë së pakut shtatë demo projekte. Kjo do të thotë se bashkëfinancimi mesatar në dispozicion është i kufizuar në 10,000 euro për projekt, por një prej kritereve ka qenë kërkimi i bashkëfinancimit nga ana e komunës aplikuese.

Po ashtu, mund të angazhohen partnerë tjerë (publik dhe privat) për ta rritur buxhetin, ndikimin dhe bashkëpronësinë e projektit. Kriteret tjera dhe më cilësore të përdorura për përzgjedhjen e demo projekteve kanë theksuar se projekti duhet të jetë i vogël por strategjik (në kohë dhe hapësirë), kreativ dhe inovativ (jo thjeshtë një projekt i vjetër i "ricikluar"), i zbatueshëm (i realizueshëm për disa muaj) dhe së fundit pjesëmarrës dhe fuqizues (duke i anga-

zhuar shoqërinë civile dhe palët tjera të interesuara). Punëtoritë për vizionim kanë ofruar mundësi të shkëlqyeshme për identifikimin e demo projekteve të mundshme në secilën komunë. Po ashtu, veprimtaritë tjera në procesin e planifikimit të Planit për zhvillimin komunal dhe urban kanë shërbyer si burim i ideve për projekte, në kuadër të procesit komunal për vizionin dhe planifikimin.

Një komisioni përzgjedhës i posaçëm, i përbërë nga përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe Sida-s, i ka përzgjedhur shtatë demo projektet e mëposhtme:

Pejë: Dizajnimi i rrugës afër Stadiumit të Futbollit

Ferizaj: Konkursi për dizajnin hapësinor të Qendrës Mobile

Gjilan: Rregullimi i Varrezave të Qytetit

Gjakovë: Përmirësimi i Parkut të Qytetit

Prizren: Përmirësimi i oborrit të shkollës në qendër të qytetit

Mitrovicë (jug): Rreth-rrrotullimet në qendër të qytetit

Mitrovicë (veri): Kalesat prë këmbësorë në qendër të qytetit

Në këtë Buletin, ju mund të lexoni më shumë për gjendjen lidhur me demo projektet në Pejë, Gjilan, Prizren dhe Mitrovicë (jug dhe veri). Ferizaji dhe Gjakova do të prezentohen në numrin e ardhshëm.

Pas një fillimi paksa me ngurrime, tani mund ta shohim qartë interesin për dhe prej demo projekteve. Në shumicën e rasteve ka qenë e nevojshme që të "zbërthehen" propozimet, në mënyrë që të inkorporohet një qasje e planifikimit, duke e inkuadruar projektin në një vizion dhe kontekst më të madh, duke iu kthyer rrënjëve të problemit dhe identifikimit të alternativave të mundshme (më të mira) nga ajo që është propozuar, si dhe më e rëndësishmja është angazhimi i të gjitha palëve të interesu-

ara dhe të qytetarëve. Po ashtu, është dashur kohë për t'u marrë me mekanizmin e bashkëfinancimit, por tani kjo është zgjidhur dhe shpresojmë të ecim tutje me realizimin. Në rastin e Mitrovicës, të dyja pjesët (veri dhe jug) ishin aq të etura për realizimin e projekt-propozimeve të tyre, sa që tashmë e kanë zbatuar fazën e parë të projektit pa bashkëfinancimin tonë. Ju ftojme ta shihni rreth-rrrotullimin e ri afër tregut të gjelbërt në qendër të pjesës jugore të Mitrovicës, si dhe rampat në qendër të pjesës veriore të Mitrovicës për këmbësorë dhe për persona me paafësi që përdorin karroce invalidësh. Kjo tregon se ekziston një interesim i vërtetë për projekte të vogla të cilat e përmirësojnë cilësinë e jetës urbane.

Sfida kryesore është krijimi dhe zhvillimi i proceseve dhe kulturave të planifikimit lokal të cilat do të jenë në gjendje të punojnë në të njëjtën kohë në vizione dhe në projekte. Ekipet duhet të punojnë në dokumentet e planifikimit si Planet zhvillimore komunale dhe urbane në njërin anë, me një vizion të mirëfilltë afatgjatë për ardhmërinë dhe strukturën e dëshiruar hapësinore të komunës, si dhe në të njëjtën kohë të nisin projektet strategjike afatshkurta (dhe afatgjata) për t'i paraqitur dobëti e vizioneve dhe planeve. Pasi këto të dyja mund të kryehet vetëm me maturi nëpërmjet bashkëprodhimit ndërmjet qeverive lokale, institucioneve tjera, komunitetit të biznesit dhe së fundi shoqërisë civile, ne dëshirojmë t'ju referojmë tek Konferenca e paradokshme botërore e planifikimit e ISOCARP-it, e mbajtur në Antverp, Belgjikë, 19-23 shtator 2007, me temën "Dialogjet urbane – Mënyrat bashkëprodhuese të ndërlihdjes së vizioneve dhe projekteve urbane strategjike". Pas realizimit të suksesshëm, MuSPP dhe partnerët e tij do të jenë në gjendje të "demonstrojnë" se si të vihet në praktikë ky Dialog urban ndërmjet planeve, projekteve dhe njerëzve.

Ekipi i MuSPP-it



KËNDI I KOMUNAVE

ANGAZHIMI I QYTETARËVE NË RINDËRTIMIN E MURIT TË SHKOLLËS

Përfshirja e qytetarëve në procesin e identifikimit të nevojave të tyre, gjetjen e mundësive dhe përzgjedhjen e prioritetëve ofron një shans më të mirë për krijimin e zgjidhjeve të reja që janë më të qëndrueshme dhe të arsyeshme. Kjo është arsyeja pse janë angazhuar nxënësit, prindërit dhe banorët tjerë gjatë zhvillimit të demo projektit me synim të rindërtimit të murit në të cilin është e vendosur rrethoja.

Ky projekt ishte identifikuar si prioritar në bazë të rezultateve të një sondazhi me 47 nxënës të shkollës fillore "Lidhja e Prizrenit", me prindërit e tyre dhe me banorët tjerë të lagjes Pantelia në Prizren.

Në bazë të rezultatit të sondazhit, rindërtimi i këtij muri me rrethojë do ta shtojë

sigurinë e nxënësve, do të ofrojë kushte më të mira për aktivitete sportive dhe do ta ndihmojë lëvizjen e lirë në oborrin e shkollës.

Prindërit shpesh e kanë theksuar se muri me rrethojë ekzistues paraqet rrezik për sigurinë e fëmijëve të tyre në këtë shkollë. Ky problem do të zgjidhet me këtë projekt të ri të bashkë-financuar nga komuna dhe Programi për Mbështetjen e Komunave në Planifikim Haësonor, i zbatuar nga UN-HABITAT në Kosovë. Sipas tyre, rindërtimi i murit me rrethojë do ta shtojë sigurinë e nxënësve dhe sigurinë e njerëzve që jetojnë në këtë lagje. Po ashtu do të përmirësohet edhe efekti pamor.

Angazhimi i palëve të ndryshme të interesuara në fazat e hershme të projektit e

ka inkurajuar procesin e planifikimit në Prizren dhe kësajohet lehtëson procesin e zbatimit të projektit. Kjo, po ashtu, është në përputhje me mandatin e UN-HABITAT-it, i cili i promovon proceset planifikuese me përfshirje dhe pjesëmarrje për zhvillimin e qëndrueshëm urban.



PUNËTORITË PËR ÇËSHTJET LIGJORE NË FERIZAJ

Duke u nisur nga fakti se planifikimi hapësinor paraqet veprimtari shumë-sektorale dhe shumë-dimensionale dhe që të realizohet kjo qasje gjatë procesit të planifikimit kërkohet analizë jo vetëm e legjislacionit hapsinor por edhe e ligjeve tjera që ndërlidhen me të.

Sfidat me të cilat ballafaqohemi gjatë zbatimit të dokumenteve të planifikimit, p.sh. shqyrtimi i rasteve për leje urbanistike dhe për ndërtim, ligjet dhe rregulloret të cilat janë në fuqi në kohën kur bëhet inspektimi në terren, ose zgjidhja e shumë kontesteve pronësore dhe kadastrale, janë të shumta, të natyrave të ndryshme dhe ka raste kur nëpunësit komunal janë në dilemë gjatë gjetjes së zgjidhjeve për to.

Një varg i punëtorive njëditore për çështjet ligjore për komunën e Ferizajt janë mbajtur në prill, maj dhe qershor kanë ofruar shumë sqarime lidhur me dilemat e sipërpërmendura. Prezantimet dhe sqarimet e bëra nga këshilltari ligjor i MuSPP/UN-HABITAT, Z. Lazim Salihu trajtuan një spektër të gjerë të çështjeve, duke përfshirë:

- Planifikimi komunal hapësinor dhe urban, kriteret ligjore
- Vendimet administrative sipas legjislacionit urban

- Ligji për ndërtimet
- Sqarimet themelore për risitë në ligjin për rrugët
- Ligji për transportin dhe ndërlidhja e tij me planifikimin hapësinor
- Ligji për tokën bujqësinë dhe ndikimi i tij në planifikim
- Ligji për konzervimin e natyrës
- Dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pasurisë së patundshme publike që administrohet nga komunat e Kosovës

Prezantimi i këtyre çështjeve dhe interpretimi i ligjeve i ka stimuluar diskutimet dhe ka ofruar sqarime shumë të mirëseardhura. Interpretimi i rasteve konkretet tashmë të zgjidhura ose në vijim të proceseve legjislative ishin tejet interesante për pjesëmarrësit.

Këto punëtori në të cilat pjesëmarrës ishin zyrtarë të drejtorive të ndryshme komunale duke përfshirë Drejtorinë për planifikim, rindërtim dhe zhvillim; Drejtorinë për urbanizëm; Inspeksion; Gjeodezi dhe kadastrë dhe prej Zyrës ligjore komunale të Ferizajt, na bënë të kuptojmë edhe më shumë rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet drejtorive si dhe gjetjen e mundësive që bashkërisht t'i tejkalojmë problemet gjatë zbatimit dhe interpretimit të legjislacionit në punëtonë të përditshme.



Pjesëmarrësit e vlerësuan përkrahjen në fushën e legjislacionit si një vlerë të shtuar për përkrahjen në vijim e sipër për planifikimin hapësinor të ofruar nëpërmjet Programit Për Mbështetjen e Komunave në Planifikim Hapësinor dhe që i përgjigjet ndryshimeve dinamike të cilat janë duke ndodhur dhe do të ndodhin në të ardhmen në legjislacion dhe në të gjitha fushat tjera në Kosovë.

"Ky lloj i përkrahjes dhe këmbimit të nevojave është i nevojshëm jo vetëm për Ferizajt, por për të gjitha komunat në Kosovë", tha Xhavit Topalli, zyrtar ligjor komunal.

Mustafë Zariqi,

Shef i sektorit për planifikim, Komuna e Ferizajt

LIDHUR ME RRETH-RROTULLIMET NË MITROVICË

Në vitin 2006, me iniciativë të MuSPP, komuna e Mitrovicës e ka themeluar grupin punues për Lëvizshmëri dhe Transport, i cili ka punuar në aspekte të ndryshme të politikës së Transportit për planifikimin hapësinor të integruar. Qëllimi i saj ka qenë që të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së mjedisit jetësor, i përqendruar në një zonë të caktuar të qytetit, i inkuadruar në strukturën ekzistuese dhe në vizionin e Planit të zhvillimit urban. Projektet kryesisht ishin të ndërlidhura me përmirësimin e qarkullimit, rrjetit rrugor dhe hapësirave publike në zonat e përzgjedhura.

Pas kërkesës së MuSPP-it për një demo-projekt në Mitrovicë, komuna e ka paraqitur një propozim për ndërtimin e rreth-rrotullimit në kryqëzimin kryesor të qytetit afër tregut të gjelbër. Projekti i zhvilluar në kuadër të grupit punues për Lëvizshmëri dhe Transport dhe i ndihmuar nga eksperti i MuSPP-it për lëvizshmëri, u miratua nga komisioni përzgjedhës.

Për shkak të urgjencës së tij, komuna e përfundoi projektin vetë, derisa u shqyrtuan edhe mundësi tjera të ndry

shme të bashkëpunimit me MuSPP/UN-HABITAT. Diskutimet me ekspertin për lëvizshmëri çuan drejt vazhdimin të propozimit fillestar dhe përfshirjen edhe të një kryqëzimi tjetër në hyrjen jugore të qytetit. Ky lokacion strategjik, përveç funksionit të tij si antipode e kryqëzimit kryesor të qytetit paraqet lidhjen e qendrës së qytetit me Parkun Solana, një hapësirë publike e rëndësishme e kësaj zone e planifikuar për rehabilitim.

Qëllimi është që të dizajnohet një projekt i cili do të burojë prej një procesi planifikues me pjesëmarrje në mënyrë që t'i arrijë objektivat kryesore; konfirmimi i këtij lokacioni si pika kryesore hyrëse/dalëse e qendrës së qytetit dhe si lidhje me parkun Solana, shtimi i sigurisë për trafikun e motorizuar dhe atë jomotorik duke e organizuar trafikun

në të gjithë sistemin, përmirësimi i koherencës së shërbimeve të transportit publik dhe shtrirja e procesit në tërë parkun Solana.

Intervenimet strategjike duhet të jenë kolektive dhe përfshirëse, duke i mobili

zuar të gjitha palët e interesuara në krijimin e pronësisë së përbashkët të projektit. Rezultatet e punëtorisë për vizionim "Ta bëjmë Mitrovicën më të mirë" ka konfirmuar se çështjet si parqet dhe hapësirat publike, shtigjet për ecje, transporti publik dhe infrastruktura e rrugëve janë disa nga prioritetet e qytetarëve të Mitrovicës. Në lidhje me këtë, mundësitë e përdorimit të integruar të gjitha resurseve në dispozicion prej komunës, komunitetit të biznesit dhe sektorit privat do të analizohen me kujdes dhe do të inkurajohen.



QASJA NË QYTET

"Handikos", OJQ që i ndihmon personat me aftësi të kufizuar në pjesën veriore të Kosovës, ka dalë me iniciativën ku për qëllim kishte uljen e skajeve të shtigjeve dhe të trotuareve për lëvizjen më të lehtë të personave me aftësi të kufizuar nëpër qytet. Projekti i përfshin tetë lokacione në pjesën veriore të Mitrovicës dhe realizimi i tij ka filluar në korrik 2007.

Faza e parë, rregullimi i skajeve të trotuareve, që ishte financuar nga Organizata ndërkombëtare për Migrim (IOM) përfshinte rrugët Mbreti Peter I, Knjaz Millosi, Ivo Lole Ribara, Vasilija Ostroskog dhe Xhon Kenedi. Dy vendpikime janë shënjuar të rezervuara për automjetet e personave me aftësi të kufizuar përpara Postës dhe në qendër të qytetit.

Po ashtu, kjo fazë e ka përfshirë Bibliotekën e qytetit, ku është adaptuar rampa për të siguruar një qasje të sigurtë për personat me aftësi të



kufizuara drejt ndërtesës. Duke pasur parasysh numrin e anëtarëve në Handikos, i cili po rritet nga dita në ditë, qëllimi kryesor i kësaj organizate është që të krijojë kushte për lëvizje më të lehtë nëpër qytet të personave me aftësi të kufizuar, ashtu që të mund të përmirësohet kushtet për jetesë të këtyre njerëzve. Faza e dytë e adaptimeve për këmbësorë, që do të bashkëfinancohet

nga MuSPP/UN-HABITAT, përfshin lokalizimin dhe krijimin e disa kryqëzimeve, si dhe qasjen në ndërtesa publike, shkolla, institucione lokale dhe në ndërtesat tjera në qytet.

Mirjana Spirić

Shefe e zyrës së Handikos-it për pjesën veriore të Kosovës

NJË UDHËTIM DRJET ARDHMËRISË

"Ishte kënaqësi të jesh pjesë e ekipit i cili tenton të krijojë një ardhmëri më të mirë për gjeneratat e ardhshme" kanë thënë pjesëmarrësit e punëtorisë gjakovare në Ohër.

Gjakova, qyteti i lumenjëve, i traditës së lashtë kulturore dhe historike, urëlidhëse me Shqipërinë ka parakushte shumë të mira për një zhvillim të mirëfillt. Mirëpo për të ndodhë kjo, këtij qyteti sikurse edhe qyteteve tjera të Kosovës i duhet një vizion i qëndrueshëm i cili do të shërbejë si një bazament mbi të cilën do të ndërtohet një perspektivë më e mirë për gjeneratat e ardhshme. Pikërisht ky ishte motivi kryesor i pjesëmarrësve të punëtorisë gjakovare në Ohër, i cili rreth veti, pos planerëve dhe ekspertëve të dëshmuar në fusha të ndryshme të jetës, mbledhi edhe përfaqësues të Shoqërisë Civile, të cilët duhet ta pranojnë se ishin "shpirti" i kësaj punëtorie.

Të vetëdijshëm se, për një çast, janë bërë pjesë e rëndësishme për ndërtimin e të ardhmës së qytetit të tyre, për katër ditë me radhë ata kanë punuar me ngulm, duke sjellë kështu shumë freski dhe ide të reja kur është fjala tek vizioni për të ardhmën. Përparësia e përfaqësuesve të Shoqërisë Civile ishte bindja e tyre se ata e dinë qartë se çfarë i nevojitet bashkëqytetarëve të tyre, banorëve të komunës së Gjakovës për përmirësimin e cilësisë së jetës.

Dhe pikërisht kontributi i tyre në këtë drejtim ishte pikënisja për ndërtimin e vizionit të qëndrueshëm për Gjakovën, mozaik ky ndërtuar së bashku me planerët dhe ekspertët e ndryshëm, i bazuar në pozitën gjeografike, resurset humane, mundësitë e zhvillimit, traditën dhe natyrisht mundësitë e izbatimit të një strategjie të tillë të quajtur "Vizioni Afatgjatë i së Ardhmës së Qytetit të tyre". Edhe përfundimet e aritura në këtë drejtim, janë rezultat i një miksture të ekspertëve, planerëve dhe përfaqësuesve të Shoqërisë Civile.

Bashkëpunimi me këtë pjesë shumë aktive të shoqërisë në Kosovën e pasluftës, ishte një përvojë e re, një stimulim për një angazhim më të madh, për një qasje më të ndryshme kur është fjala tek ndërtimi i vizionit për të ardhmën.



"Vizioni Afatgjatë për të Ardhmën i gjason një ëndrrë, e cila në një të ardhme të shpejtë mund të bëhet realitet, meqë edhe pse për momentin ëndërr, ajo është e bazuar në vlerat dhe mundësitë e zhvillimit të komunës së Gjakovës, edhe pse për këtë kërkohet shumë mund, lypset një angazhim i gjithëmbarshtëm dhe një qasje krejtësisht tjetër e menagjimit të komunës" – kanë thënë pas përfundimit të kësaj punëtorie, përfaqësuesit e Shoqërisë Civile të Gjakovës, të cilët kanë

falënderuar UN-HABITAT-in, për mundësinë që iu është dhënë për të qenë pjesëmarrës i një punëtorie, dhe për çështjet e veçanta kur është fjala tek ndërtimi i ardhmërisë për fëmijët e tyre dhe gjeneratat e ardhshme.

Faton Canhasi,

Anëtar i këshillit joformal të shoqërisë civile, Gjakovë


DEMO PROJEKTI: VARREZAT KRYESORE TË QYTETIT NË GJILAN

Prej gjashtë projekteve të identifikuara nga komuna e Gjilanit, duke përfshirë informatat gjeografike të digjitalizuara, linjën e autobusit urban, projektin e rritjes së sigurisë në trafik, shenjëzimin e rrugëve, mbikalimin e sigurt për shkollën në Bresalc dhe përmirësimin e varrezave të qytetit, komisioni përzgjedhës e ka miratuar këtë të fundit. Projekti për përmirësimin e varrezave të qytetit është zgjedhur si demo projekt për t'u zbatuar nga komuna dhe MuSPP/UN HABITAT.

Në ndërkohë, projekti për sigurinë në shkollë do të zhvillohet si pilot projekt në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe do të jetë një test për rritjen e sigurisë së trafikut afër shkollave që gjenden pranë rrugëve kryesore anembanë Kosovës. Objektiv i kryesor i projektit për përmirësimin e varrezave të qytetit është që të përmirësohet cilësia e hapësirës publike, t'i jepet një karakter respektues vendit të funeraleve dhe që ato të integrohen me mjedisin urban. Aktualisht, varrezat janë një vend i mbushur me mbeturina, me barë dhe me shkurre të rritura, me rrethojë të rrezuar dhe me

shenja vandalizmi në tërë hapësirën e tyre. Për t'i zgjidhur këto probleme, është propozuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe strukturore. Do të bëhet inventarizimi i lokacionit ekzistues si dhe i kapacitetit hapësor të tij për të planifikuar shfrytëzimin e ardhshëm të varrezave për qëllime të varrimit duke pasur parasysh aspektet mjedisore dhe shëndetësore. Dizajni dhe planimetria e re e varrezave do të mëtojë të sigurojë respektin për të vdekurit e varrosur aty pavarësisht nga përkatësia fetare e tyre. Elementet për t'u marrë parasysh janë: një mjedis i gjelbër për qytetarët, përmirësimi i pjesëve të vjetra, respektimi i riteve të kulturave të ndryshme gjatë funeraleve, elementet themelore dizajnuese (monumentet, infrastruktura fetare, ...) dhe integrimi në mjedisin urban (muret e jashtme).

Në fund, do të elaborohet një sistem i menaxhimit dhe mirëmbajtjes duke i zbatuar rregulloret ligjore për vendet për varrim dhe një sistem i koncesioneve dhe menaxhimit financiar. Projekti do të zbatohet në mënyrë pjesëmarrëse, veçanërisht për shkak të karakterit shumetnik. Kjo qasje dhe rezultatet e saj



do të mund të përdorëshin për ta zgjidhur në mënyrë të qëndrueshme problemin e varrezave në tërë Kosovën.

DEMO PROJEKTI NË PEJË

Komuna e Pejës ka vendosur që të bëjë zbatimin e demo projektit që është propozuar në bashkëpunim me Drejtorinë e punëve publike dhe shërbimeve teknike, Drejtorinë për planifikimin urban dhe rural, për zhvillim dhe mjedis dhe me ekipin lokal të MuSPP të UN-HABITAT-it.

Ky demo projekt, i cili është i përkrahur nga Bordi i drejtorëve i Pejës, i takon kategorisë së projekteve të Lëvizshmërisë. Në këtë aspekt, projekti është një mundësi për t'i demonstruar praktikisht qëllimet e idesë së "Portës së Qytetit", e cila është pjesë e propozimit të Politikës komunale për lëvizshmëri në kuadër të projekt udhërrëfyesit për zbatimin e Planit zhvillimor urban.

Demo projekti i propozuar synon në sigurimin e organizimit më të mirë dhe më efikas të qarkullimit të trafikut një prej pikave kryesore të kontaktit me qytetin, promovimin e aspekteve të ndryshme të sigurisë së trafikut dhe theksit në këmbë-

sorë, sigurimin e shërbimeve themelore për transportin publik dhe ndikimin në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj zone.

Zona ndërmjet parkut të qytetit Karagaç dhe stadiumit të futbollit në Pejë ndodhet përgjatë rrugës që vjen prej drejtimit Gjakovë-Deçan. Zona ndërmjet rrugës dhe stadiumit të futbollit ka një gjërësi që sillet prej 35 deri në 50 metra. Në anën tjetër të rrugës, ekziston një shirit ndërmjet rrugës dhe parkut e gjërësi prej pothuaj 10 metrave.

Të dyja anët e rrugës përmbajnë shumë funksione joformale, si vend ndalje e autobusëve dhe kombi busëve ndërmjet Pejës, Deçanit, Gjakovës dhe Prizrenit, si dhe për disa linja ndërkombëtare të autobusëve (për në Podgoricë, Ulqin, Tiranë, Durrës, Sarajevë...), treg për mallra të imëta, për perime dhe për dru zjarri. Në të njëjtin lokacion ndodhet edhe një hapësirë për parkim, që përdoret kryesisht gjatë ndeshjeve të futbol-

lit, vend pritjeje për taksit dhe trotuar. Bizneset joformale kontribuojnë në deponinë e bërllokut të krijuar rishtazi në këtë zonë.

Në cepin verior ndodhet stadiumi i futbollit, hapësira përreth stadiumit të futbollit është e ngatërruar, por ekzistojnë mundësitë për përmirësimin e kësaj zone. Prandaj, stadiumi do të transferohet në një zonë arsimore dhe rekreative kurse ajo hapësirë do të zhvillohet si një zonë e re banimi. Parkingjet e duhura për automjete dhe hapësirat për mallra dhe standat për ushqime do të bëhen pjesë e këtij përmirësimi.

Komuna e ka shpallur konkursin nëpër gazeta për paraqitjen e aplikacioneve nga ana e kompanive me të drejtë konkurimi. Pritet që zbatimi do të nisë menjëherë pas përzgjedhjes së kompanisë dhe pasi të jenë zgjidhur disa çështje procedurale me administratën e komunës së Pejës.

ZONA ARSIMORE, SPORTIVE DHE TURISTIKE NË PEJË

Më 12 shtator, në një takim publik janë prezantuar rezultatet e punëtorisë për vizionin lidhur me ish-kazermat e ushtrisë në Pejë. Vendi i mbajtjes së këtij takimi ishte Universiteti i vizionit evropian në Pejë, në të cilin kanë marrë pjesë një numër i madh i palëve të interesuara dhe i zyrtarëve komunal.

Pas fjalës hyrëse të mbajtur nga Shkelzen Hyseni, KE i komunës së Pejës, përfaqësuesit e UN-HABITAT-it e paraqitën një pasqyrë të metodologjisë së aplikuar. Deklaratën e përbashkët për vizionin e paraqiti Agron Sallova, këshilltar për planifikimin urban i UN-HABITAT-it.

Deklarata e vizionit thekson se zona e re arsimore, sportive dhe turistike "AST" do të zhvillohet në rrëzat e Parkut Nacional të Bjeshkëve të Nemuna, i rrethuar nga lagjet Zatra, Dardania dhe Bellopoja dhe nga Parku Karagaç. Ajo do të jetë një atraksion tërheqës dhe me qasje të lehtë për të gjitha qendrat tjera të rajonit. "AST" do të bëhet pjesë e ofertës turistike të rajonit të Dukagjinit dhe do të jetë një vend ku bashkohen natyra dhe shëndeti. Po ashtu, ajo do të bëhet një qendër intelektuale për tërë rajonin, duke ofruar hapësira për Universitetin e Sporteve. Përkritazi me funksionin sportiv, "AST" do të jetë konkurrent në rajon lidhur me organizimin e garave të ndryshme ndërkombëtare.

Pas kësaj deklarate për vizionin, përfaqësuesit e secilit prej katër grupeve tematike i kanë paraqitur pjesët e tyre të vizionit. Grupi i parë ka punuar lidhur me natyrën, ujin dhe mjedisin. Elementet e dizajnit të tyre përmbajnë pjesët për kanalizimin, kanalet kundër përmytjeve dhe për energjinë diellore. Shumë hapësira të gjelbërta duhet të plotësojnë restaurimin e kopshtit botanik në Parkun Karagaç.

Grupi i tretë e ka zhvilluar një koncept për temat e arsimit, sportit dhe turizmit. Kjo përfshin një skilift të ri për të zhvilluar një qendër skijimi. Është paraparë edhe akomodimi hotelier dhe sportiv, si dhe restaurimi i pishinës së vjetër dhe planimetria e shtigjeve për ecje dhe për biçikleta.

Koncepti i tretë përmban zonën e banuar dhe rrethinën. Lokacionet për hotel dhe ndërtesat arsimore janë dizajnuar, si dhe zonat për rekreacion, banesa dhe natyrë. Dizajni i katërt është fokusuar në çësht

Mësimet e nxjerra gjatë punëtorisë së vizionimit për zonën "AST" në Pejë

Pjesëmarrësit në këtë punëtori kishin një qasje serioze ndaj çështjes së diskutuar dhe mund të themi pa hezitim se janë arritur rezultate të mira të cilat mund të përdoren në interes të komunës. A do të përdoret apo jo kjo përvojë e mirë dhe rezultatet nga punëtorja, para së gjithash varet nga institucionet kompetente komunale. Le të shohim!

Sipas mendimit tim, mësimet e nxjerra prej kësaj punëtorie përfshijnë:

- Të kuptuarit se puna në grupe jep rezultate të qëndrueshme
- Domsdoshmëria e pjesëmarrjes së spektrit të gjerë të pjesëmarrësve të angazhuar në çështjen përkatëse
- Rëndësia e të qenit tolerant në grupet punuese
- Pranimi i argumenteve si vlera e jo si akuza ose kritika
- Të gjithë pjesëmarrësit në punëtori ishin të barabartë
- Ne kemi mësuar si të organizojmë një punëtori
- Rëndësia e disiplinës, mirësjelljes dhe qasjes serioze të organizatorëve
- Roli i rëndësishëm i logjistikës dhe pajimeve vizuale në një punëtori të suksesshme
- Niveli profesional i moderimit, drejtimit dhe përshtypja e mirë lidhur me bashkëpunimin me organizatorët e punëtorisë

Reshat Nurboja,

drejtor i OJQ-së Lidhja Qytetare e Kosovës në Pejë

Për mua si zyrtarë për çështje gjinore në komunë, ka qenë një nder për të marrë pjesë në Ekipin komunal për planifikim dhe unë e kam pranuar me kënaqësi ftesën për të marrë pjesë në këtë punëtori, ashtu që të mund të kontribuoj me këndvështrimin tim për të mirën e qytetit tim.

"Nevojat e ndryshme të prioritetëve të femrave dhe të meshkujve, llojet e ndryshme të shërbimeve dhe të infrastrukturës duhet të përfshihen në zhvillimin lokal" u tha në këtë punëtori, deri sa u theksua shpresa që kjo përvojë në këto çështje do të na ndihmojë që t'i realizojmë projektet tona të ardhme me qasje të barabartë duke respektuar nevojat e të gjitha grupeve në shoqëri.

Unë shpresoj se nga kjo punëtori e frytshme, ne si komunë kemi mësuar përvoja të cilat do të na shërbejnë në punën tonë të ardhshme, ashtu që ne do të mundohemi t'i zbatojmë në praktikë në rregullimin e kësaj qendre arsimore dhe sportive, ashtu që qyteti të fitojë një qendër profitabile arsimore, sportive dhe turistike, çfarë nuk kemi pasur deri më tani.

Sebahate Qorkadiu,

Zyrtare për çështje gjinore në komunën e Pejës



jet e rrjetit dhe ka dalë me propozime për qarkullimin ndërkombëtar, transportin publik dhe objektet tjera specifike për këmbësorë biçiklistë dhe persona me aftësi të kufizuara. Pas këtyre prezantimeve është

paraqitur një përmbledhje e pikave të pajtimit dhe mospajtimit, si dhe janë nxjerrë rekomandimet për komunën. Pas prezantimit ka pasur një diskutim, pas të cilit janë shërbyer pije nga universiteti.

TRAJNIMI PËR PLANIFIKIMIN URBAN TË INTEGRUAR

Faza e parë e Trajnimit për Planifikimin Urban të Integruar është mbajtur në Suedi në shkurt dhe mars të vitit 2007. Faza e dytë u zhvillua në Vientiane të Laosit, me delegatët nga 16 vende, duke përfshirë edhe Kosovën.

Objektivi i përgjithshëm i Programit ndërkombëtar të aftësisë, i ofruar nga Sida, është që të fuqizojë dhe zhvillojë ndërtimin e kapaciteteve të planifikuesve dhe vendimmarrësve të lartë në vendet në zhvillim për krijimin e kapaciteteve dhe njohurive në fushën e planifikimit të urban integruar.

Faza e dytë e programit në Laos përfshinte: Planifikimin Urban në Laos, vizitat në terren, studimet e rasteve, prezantimet të projekteve të vogla, etj. Planifikimi në Laos ka dy nivele: nivelin qendror dhe atë lokal. Niveli qendror përfshinë nivelin kombëtar dhe atë rajonal. Niveli lokal ka të bëjë me planet krahinave dhe qarqeve, ku hyjnë master plani urban dhe planet e detajuara. Planifikuesit në Laos kanë zhvilluar projekte të ndryshme të planifikimit me këto objektiva:

- Zbutjen e varfërisë
- Përmirësimin e kushteve jetësore, mjedisit urban dhe qasjes në infrastrukturë dhe shërbime
- Krijimin e një kornize të decentralizuar dhe të përkushtuar institucionale dhe menaxhuese; krijimin e Autoritetit për Administrimin e Zhvillimit Urban



(AAZHU) dhe transferimin e shërbimeve urbane te AAZHU. Ky aftësim dypjesësh (në Suedi dhe Laos) ishte interesant pasi që u dha pjesëmarrësve mundësinë e shkëmbimit të përvojave dhe ideve në lidhje me planifikimin urban me vendet dhe kontinentet e ndryshme, si dhe ofrojë koncepte dhe teknika në fushën e Planifikimit Urban të Integruar.

Koncepti i aftësisë ka qenë në përputhje me parimet ndërkombëtare dhe standardet evropiane. Ky koncept mund të përdoret për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm dhe për zbutjen e varfërisë, të cilat janë qëllime të rëndësishme në procesin e planifikimit në Kosovë.

Artnet Haskuka

Këshilltare për Planifikim Urban/ Komunal, UN-HABITAT në Prizren

PËRVOJA E MËSIMIT NGA

PROGRAMI GLOBAL PËR STUDENTËT NË UDHËHEQJE DHE MENAXHIM TË NDËRMARRJEVE

Si një femër aktive e komunitetit rom-ashkali-egjiptian (RAE) në Kosovë, mua më ishte dhënë rasti të marrë pjesë në "Programin global për studentët në udhëheqje dhe menaxhim të ndërmarrjeve" në Kolegjin Manhattanville në Nju Jork. MuSPP/ UN- HABITAT-i ia kishte paraqitur organizatorëve kandidaturën time për këtë program.

Unë studioj psikologjinë; jam anëtare e një OJQ-je lokale të quajtur "Qendra për Integrim Ndërkombëtar" dhe anëtare e grupit punues brenda Strategjisë së Qeverisë së Kosovës për integrimin romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve. Ky program gjashtë javor më dha mua besimin, aftësinë dhe njohuritë për tu bërë agjente për ndryshim në vendin tim dhe për të qenë zbatuese e një prej vizioneve të tij, për krijimin e një rrjeti mbarëbotëror të femrave të reja që shërbejnë si udhëheqëse lokale. Diversiteti i femrave në këtë program më dha mua mundësi që të mësojë nga përvojat ndërkombëtare si dhe nga praktikat më të mira nga e gjithë bota, si nga: Tanzania, Japonia, Zimbabveja, Kenia, Rumania, Brazili, Meksiko dhe Nigeria.

Njohuritë që fitova mbi menaxhimin e ndërmarrjeve dhe mbi çështjet e tjera janë më se të domosdoshme për të transformuar komunitetin tim, i cili edhe është një nga qëllimet e mia në të ardhmen. Unë po ashtu shpresoj se do t'i jap një shtytje demokracisë së avancuar në qytetin tim, në Gjakovë, dhe në përgjithësi në vendin tim.

Mimoza Gavrani,

Anëtare e OJQ-së 'Qendra për Integrim Ndërkombëtar'

KRIJIMI I HAPËSIRAVE – BIENALJA E VII-TË E PLANIFIKIMIT

Bienalja e shtatë e Qyteteve Evropiane dhe e Planifikuesve të Qyteteve, e mbajtur prej 21 deri më 23 qershor 2007 në Budapest të Hungarisë, u përqendrua në marrëdhëniet në mes të planifikimit urban dhe përdorimit të dizajnit urban si një mekanizëm për zhvillim të qëndrueshëm urban. Konferenca ishte mjaft e balancuar dhe në mëngjes pati folës të rëndësishëm ndërkombëtar dhe vendorë ndërsa gjatë pasdites punëtori në terren. Konferenca u mbyll me një seancë ku lajmërua përmbajtja e bienales së ardhshme (Nans/ Francë, 2009).

Edhe fjalimet kryesore ishin mirë të balancuara ndërmjet qasjeve teorike të planifikimit dhe dizajnit urban bashkëkohor, si dhe ligjëratave të orientuara në mënyrë më praktike rreth asaj se si

të zbatohet teoria në praktikë. Me interes të veçantë për programin MuSPP ishin ligjëratat e Prof. Jon Lang "Cilësia e hapësirave urbane përmes kontrollimeve të zhvillimit" dhe ajo e Cliff Hague "Aftësitë e përgjithshme për projektim të mirë urban" (me një "përmbledhje zbatimëse të aftësive të reja" në fund). Ligjëratat e Prof. Langut na inspiroi neve që të formulojmë Detyrat e punës për një Projektues urbanistik/Ekspert të hapësirës publike, i cili së shpejti pritet të bëjë zbatimin e ekipin e MuSPP-së.

Ky ekspert do të këshillojë MuSPP dhe gjashtë komunat për "krijimin e vendeve me gjallëri", si një kontribut shumë i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm urban. Por, të kthehemi sërish të Bienalja. Me siguri fjalimi më i

rëndësishëm ishte ai i Dr. Larry Beasley, ish drejtor i planifikimit në Vankuver të Kanadasë, i cili me pak fjalë bëri një gërshetim brilant të PR të Vankuverit dhe ABC-së për një planifikim dhe zhvillim të mirë urban. Sa i përket punëtorëve në terren, rigjallërimi i lagjeve të pazhviluara të banimit (www.ferencvaros.hu) dhe prodhimi i mëhershëm i gazit në parkun e teknologjisë (www.graphisoft.com) ishin raste interesante të mësimi të cilat përmbanin praktika të mira të planifikimit, të cilat janë të rëndësishme edhe për Kosovën.

Raporti i plotë mund të merret në zyrën e MuSPP, ndërsa të gjitha informatat rreth këtyre ligjëratave mund të gjinden në www.makingplaces.hu.

MUSPP NË PROGRES

Takimi i tretë për Zhvillimin e Programeve (TZHP) i UN-HABITAT/MuSPP, u mbajt më 12 korrik 2007. Takimi u përqendrua në pesë tema kryesore të Programit MuSPP: komunikimi, udhërrëfyesit për Planet Zhvillimore Komunale (PZHK) dhe Planet Zhvillimore Urbane (PZHU), demo projektet, çështjet e vendbanimeve joformale dhe lëvizshmërisë (ndryshueshmërisë). Ky takim mblodhi zyrtarët komunalë, donatorët dhe palët e tjera të interesit. Rëndësia e **komunikimit** u vu në pah përmes prezantimit të faqes së internetit të UN-HABITAT-it në Kosovë (www.unhabitat-kosovo.org), si një kanal i komunikimit me partnerët, komunat dhe palët e tjera me interes dhe lidhjet e tij të mundshme me faqet përkatëse të internetit të partnerëve. Në takim u diskutua edhe për mekanizmat e tjera të komunikimit dhe informimit, p.sh., për buletin e MuSPP-së. Rëndësia që kanë **udhërrëfyesit** për PZHK/PZHU u theksua duke i konsideruar ato si një mjet për përfundimin me kohë të procesit të planifikimit duke siguruar që ai të jetë cilësor. U diskutua për gjendje në gjashtë komunat pjesëmarrëse sa i përket PZHK/PZHU-ve, Punëtorive të vizionimit, njësive të planifikimit dhe Këshillit Joformal të Organizatave të Shoqërisë Civile (KOSHC). U diskutua edhe për një përshkrim të shkurtër dhe për informacione të përgjith



shme për secilin nga **demo projektet** e zgjedhura. U bë e qartë nga diskutimet se secila komuna do të duhet të zhvillojë një plan të veprimit si dhe ta lidh projektin me deklaratën për vizion, PZHK/PZHU, si dhe të përfshijë palët e interesuara. Sa i përket **vendbanimeve joformale** (VJ), u theksua se tashmë është punuar mjaft shumë në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve që kanë të bëjnë me vendbanimet joformale, p.sh., është mbajtur një punëtori për vendbanimet joformale, janë organizuar fushata publike/ konferenca për shtyp, janë botuar fletushka, pllakate dhe janë mbajtur dy fushë-punëtori në Gjakovë dhe në Pejë. Prezantimi shkoi edhe më larg duke theksuar disa prej shkaqeve që sjellin deri te krijimi i VJ-ve, që janë, urbanizimi i shpejtë, pamundësia për të siguruar tokë dhe banim, sektori i dobësuar publik, gjë që inkurajoi pjesëmarrësit të mendojnë për të zgjidhur çështjen e VJ-ve. Kjo çoi në një diskutim interaktiv rreth VJ-ve dhe kjo solli paraqitjen e shumë sugjerimeve, e kjo nënkupton se duhet të mbahet një punëtori për paraqitjen e vizionit mbi VJ-të për të diskutuar edhe shembuj të tjerë.

U diskutua edhe për çështjet e **lëvizshmërisë** duke i kushtuar vëmendje konferencës së ardhshme për lëvizshmërinë dhe transportin dhe disa aktivitetet e tjera në kuadër të MuSPP-it, si p.sh., Javës evropiane të lëvizjes në shtator. Këto kishin për qëllim krijimin e një lidhjeje ndërmjet shoqërisë civile, politikave të transportit dhe projekteve të ndryshme për lëvizshmërinë në komunat që marrin pjesë në program. Po ashtu u theksua nevoja për përfshirjen e lëvizshmërisë në demo projekte, siç është rasti me ri-projektimin e qendrës së qytetit dhe vendkalimit të hekurudhës në Ferizaj, rrethrotullimi në Mitrovicën Jugore, siguria rrugore në Gjilan dhe rrjeti i qarullimit të autobusëve urban në Pejë. TZHP-ja i tretë u ofroi pjesëmarrësve një pasqyrë të përgjithshme të MuSPP-it. Ai po ashtu nxiti diskutime të hollësishme ndërmjet komunave pjesëmarrëse dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Takimet për Zhvillimin e Programeve nxisin shkëmbimin e informatave dhe përvojave, i kontribuojnë ndërtimit të kapaciteteve dhe mbi të gjitha mund të veprojnë si platformë për shkëmbimin e ideve të reja.

KËNDI I UN-HABITAT-IT

UN-HABITAT-I LANSON NJË ALEANCË TË RE GLOBALE PËR UJIN

Një Aleancë e re e Partneritetit të Operatorëve Global të Ujit (APOGU) që synon të përmirësojë qasjen në ujë dhe kushte sanitare për më të varfrit e më të varfërve, u lansua në Kuvendin e Javës Botërore të Ujit në Stokholm të Suedisë me 15 gusht 2007.

Aleanca u lansua nga H.R.H. Princi i Portokallit i Holandës, në darkën ceremoniale të organizuar nga Drejtoresha Ekzekutive e UN-HABITAT-it, Znj. Anna Tibaijuka. Në mesin e mysafirëve kishte përfaqësues të donatorëve, të vendeve përfutuese dhe të organizatave partnere të UN-HABITAT-it, përfshirë edhe UN-Uji, Konferenca Ministrorë Afrikane mbi Ujin, Këshilli i Bashkëpunimit për Ujë dhe Kushte Sanitare dhe Instituti Ndërkombëtar Suedez i Ujit, organizatorë i Javës Botërore të Ujit në Stokholm.

H.R.H. Princi i Portokallit, në cilësinë e tij si kryesues i Bordit Këshillues të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Ujin dhe Kushtet Sanitare, u tha mysafirëve të mbledhur se APOGU do të ndihmojë qeveritë dhe agjencitë donatore që të fuqizojnë autoritetet dhe komunitetet lokale me resurse dhe me kapacitetin e nevojshëm profesional për të menaxhuar furnizimin me ujë dhe ofrimin e shërbimeve sanitare, detyrë kjo e cila ishte identifikuar si shumë e rëndësishme nga Grupi punues mbi Ujin i Projektit të Mijëvjeçarit.

Znj. Tibaijuka tha se Aleanca e re përpiket të krijojë një rrjet botëror që do të ndihmojë në përkrahjen e operatorëve që ofrojnë shërbime të ujësjellësit dhe sanitare.

Propozimi për themelimin e Aleancës

përbën një pjesë të përmbledhjes së veprimeve, të njohura si Plani Hashimoto i Veprimit, i dizajnuar për zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve kyç të përfshirë në sektorin e ujit dhe atë sanitar. Ai është miratuar dhe ka marrë përkrahjen e shumë organizatave ndërkombëtare dhe rajonale.

Pjesëmarrësit e takimit të liderëve botërorë në Samitin e Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara në vitin 2000 u zotuan se do të arrijnë synimin nr. 10 të Objektivit Zhvillimor të Mijëvjeçarit nr. 7, 10 që deri në vitin 2015 të bëhet përgjysmimin e numrit të njerëzve që nuk kanë qasje të qëndrueshme në ujë të sigurt të pijes. Në vitin 2002, Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm në Johannesburg përfshiu synimin që deri më 2015

Burimi: www.unhabitat.org

Në këndin e Mediave kemi zgjedhur disa tituj e citime interesante në lidhje me planifikimin urban dhe zhvillimet në Kosovë. Artikujt originalë mund t'iu dërgohen sipas kërkesës.

MITROVICË

Të gjithë së bashku për një qytet më të mirë

Zyrtarët e UN-HABITAT-it i kanë prezantuar rezultatet e Punëtorisë për paraqitjen e vizionit të Mitrovicës "Ta Bëjmë Mitrovicën më të Mirë", e cila është mbajtur në Shkup në janar të këtij viti, ku ishin të pranishëm planifikuesit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile nga të dy anët e qytetit. Kriza ekonomike dhe cilësia e ulët e jetesës me të cilat po ballafaqohen qytetarët e të dy pjesëve të qytetit ishte pika e fillimit të diskutimeve dhe dialogut ndërmjet të dy komuniteteve. Sipas përfaqësuesve të UN-Habitat-it, rezultatet e dala nga kjo punëtori ju dorëzuan autoriteteve komunale si ndihmë për hartimin e PZHK dhe PZHU.

Burimi: Koha Ditore, 12.07.07

GJAKOVË

Prezantohet vizioni për Gjakovën

Artikulli ofron informacione rreth prezantimit të vizionit për të ardhmen e komunës "Gjakova 2015+". Deklarata e zhvilluar për vizionin, e cila është mbështetur edhe nga Kryeshefi Ekzekutiv, Pal Lekaj, si një objektiv për zhvillimin e ardhshëm, është: "Gjakova me trashëgiminë kulturore, me vlera historike dhe natyrore, qytet i lumenjve, qendër kryesore e zhvillimit ekonomik, qendër bujqësore dhe malore, zonë e gatshme për bashkëpunim me të gjitha qytetet e tjera evropiane dhe të rajonit".

Burimi: Kosova Sot 14/07/2007

GJILAN

Prioritetet do të vendosen nga qytetarët

Komuna e Gjilanit e paraqiti para qytetarëve të saj qarkoren e buxhetit për vitet 2008 – 2010, në takimin e parë me qytetarë. Nuhi Nuhiu, Ushtrues Detyre i Drejtorit për Buxhet, Financa dhe Investime, tha se kjo metodë është një formë e re e hartimit të buxhetit; përmes të cilës drejtoritë do t'ua paraqesin buxhetet e tyre qytetarëve, ndërsa qytetarët praktikisht do kenë mundësi të japin sugjerimet e tyre për projektet e rëndësishme. "Në bazë të këtyre propozimeve hartohet lista përfundimtare e prioriteteve nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe në fund ajo miratohet nga Asambleja Komu-

nale", tha Nuhiu duke ju bërë thirrje sërish qytetarëve që të jenë aktivë në proces, i cili do të ofrojë më shumë mundësi që ata të përfshihen në marrjen e vendimeve.

Burimi: Kosova Sot, 01.08.07

PEJË

Deklarata e Vjenës, një shembull për Planin Urban

U bë një premtim për integrimin e vendbanimeve joformale në debatin e Pejës, të organizuar nga KK e Pejës, Asociacioni i Komunave të Kosovës, IPVQ-të, OSBE dhe UN-HABITAT-i, ku u mbledhën autoritetet lokale dhe ndërkombëtare për të diskutuar mundësinë e zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban të Pejës, të hartuar para një viti nga kompania holandeze DHV. Frank D'hondt, (Koordinator i Planifikimit Hapësinor) në UN-HABITAT, theksoi se PZHU i Pejës është shembull për komunitat e tjera. Kryetari i Komunës, Ali Lajçi tha se plani që tashmë është miratuar nga Ministria e Planifikimit Hapësinor, është një perspektivë e re jo vetëm për vendbanimet si "Zatra" dhe "Kristali" por është edhe një kufi për të ndaluar njëherë e përgjithmonë ndërtimet e paligjshme. Agim Radoniqi, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, tha se është e domosdoshme që institucionet ligjvënëse të "integrojnë Deklaratën e Vjenës në Planin e Përgjithshëm Urban".

Burimi: Koha Ditore 15.06.2007

FERIZAJ

Ministri Gjini viziton Ferizajin

Artikulli jep informacione rreth vizitës që Z. Ardian Gjini, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i bëri autoriteteve lokale të komunës së Ferizajt. Çështjet e diskutuara në këtë takim kishin të bënin me sigurimin e ujit të pijshëm, projektet për kanalizimin dhe deponinë e hedhurinave në fshatin Slivovë, e cila ka disa vite që është duke i shkaktuar probleme komunës. Një pjesë e diskutimit kishte të bënte edhe me bifurkacionin e Nerodimes dhe me planin hapësinor të Ferizajt. Përfaqësuesit e autoriteteve qendrore dhe lokale po ashtu diskutuan edhe për krijimin e kushteve për një mjedis më të mirë dhe më të pastër në Ferizaj. "Çështjet e diskutuara janë çështje për të cilat kërkohet bashkëpun-

im i ngushtë në mes të nivelit qendror dhe atij lokal", tha Ministri Gjini. Ai po ashtu theksoi se Ministria do të bëjë më shumë në mbrojtjen e fenomenit të bifurkacionit, pasi ai ka rëndësi të veçantë për trashëgiminë natyrore në Kosovë.

Burimi: www.ferizaj-komuna.org, 11.07.2007

PRIZREN

Gryka e Marashit, një qendër e re rekreative në periferi të Prizrenit

Ky artikull paraqet informacione mbi zhvillimet e reja në Prizren. Derisa deri para një viti, Shadërvani ishte vendi më i preferuar i njerëzve për të ecur, tani ky privilegj ka kaluar diku tjetër, në kompleksin e Marashit, një zonë shumë e bukur afër Prizrenit, që është bërë vendi i preferuar nga qytetarët për të ecur dhe për rekreacion. Një nga institucionet që ka merita të mëdha për këtë është Asambleja Komunale e Prizrenit. Qytetarët janë të kënaqur që komuna e tyre tani e ka një vend të ri për rekreacion.

Burimi: Lajm, 17.07.07

Takimi ministror joformal mbi zhvillimin urban dhe kohezionin territorial

Me 24 dhe 25 maj 2007, u mbajt një takim ministror joformal mbi zhvillimin urban në Lajpcig nga Presidenca gjermane e BE-së. Aty u miratuan dy dokumente të politikës, Karta e Lajpcigut mbi qytetet e qëndrueshme dhe Agjenda territoriale e BE-së. Rrjeti Evropian për Mbikëqyrjen e Planifikimit Hapësinor (ESPON) mori pjesë në këtë takim duke prezantuar rezultatet kryesore të programit ESPON 2006 dhe pasqyrën e parë mbi prioritetet për programin ESPON 2013. Duke pasur parasysh rezultatet e ESPON-it në programin 2000-2006, ministrat "u pajtuan që të mbështesin edhe Agjendën territoriale të BE-së edhe Kartën e Lajpcigut". Ministrat në mënyrë të veçantë rekomanduan që "Programi ESPON 2013, në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Evropian, të bëjë analiza më të thella mbi efektin e politikave të BE-së në kohezionin territorial, të zbulojë lidhjet mes shkakut dhe efektit, dhe të zhvillojë treguesit operacional për raportim të rregullt mbi çështjet territoriale".

Burimi: Buletini i 8të i ESPON-it, Lexoni më tepër në: www.espon.eu

POLITIKAT URBANE TË BE-SË

KARTA E LAJPCIGUT MBI QYTETET E QËNDRUESHME EVROPIANE

"Karta e Lajpcigut për Qytetet e Qëndrueshme Evropiane" është një dokument i shteteve anëtare të BE-së, i cili është hartuar me pjesëmarrjen e gjerë dhe transparente të palëve të interesuara evropiane. Duke ditur sfidat dhe mundësitë, si dhe të kaluarën e ndryshme historike, ekonomike, shoqërore dhe mjedisore të qyteteve evropiane, ministrat e shteteve anëtare përgjegjës për zhvillimin urban, u pajtuan rreth parimeve dhe strategjive të përbashkëta për një politikë të zhvillimit urban. Ministrat zotohen se do të:

- Fillojnë debatin politik në shtetet e tyre mbi atë se si të integrohen parimet dhe strategjitë e Kartës së Lajpcigut për qytetet e qëndrueshme evropiane në politikat zhvillimore shtetërore, rajonale dhe lokale
- Shfrytëzojnë zhvillimin e integruar urban dhe qeverisjen përkatëse si mjet për të zbatuar kartën dhe të krijojnë për këtë qëllim çdo kornizë të nevojshme në nivel shtetëror, dhe
- Promovojnë themelimin e një organizimi të balancuar territorial të bazuar në strukturën urbane policentrike evropiane

Rekomandimet e kartës së Lajpcigut përfshijnë:

Shfrytëzimin më të madh të qasjeve të politikës së zhvillimit të integruar urban
Politika e zhvillimit të integruar urban nënkupton shqyrtimin e njëkohshëm dhe të drejtë të shqetësimeve dhe interesave të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin urban. Politika e zhvillimit të integruar urban është një proces në të cilin aspektet hapësimore, sektoriale dhe kohore të fushave kyçe të politikës urbane janë të koordinuara. Politika e zhvillimit të integruar urban është prerogativë kryesore për zbatimin e Strategjisë së BE-së për zhvillim të qëndrueshëm. Qyteteve evropiane u rekomandohet që të shqyrtojnë hartimin e pro-

grameve për zhvillimin urban të integruar për qytetin si tërësi. Duhet të fuqizohet edhe më shumë koordinimi në mes të nivelit të qytetit dhe rajonit.

Strategjitë kryesore për veprim në kuadër të politikës së zhvillimit urban të integruar, të cilat kanë shumë rëndësi për forcimin e aftësisë konkurruese të qyteteve evropiane, janë:

- Krijimi dhe sigurimi i hapësirave publike të cilësisë së lartë
- Modernizimi i rrjeteve të infrastrukturës dhe përmirësimi i efikasitetit të energjisë
- Inovacioni proaktiv dhe politikat arsimore

Vëmendje e veçantë brenda kontekstit të qytetit si tërësi i kushtohet lagjeve të pazhvilluara

Qytetet ballafaqohen me sfida të mëdha, veçanërisht kur është fjala te ndryshimet në strukturën ekonomike dhe shoqërore dhe globalizimin. Disa prej problemeve specifike, mes tjerash, janë edhe niveli i lartë i papunësisë dhe i përjashtimit social. Dallimet shoqërore dhe dallimet në zhvillimin ekonomik shpesh janë në rritje, çka ndikon në destabilizimin e qyteteve. Një politikë e integrimit shoqëror e cila kontribuon në uljen e pabarazisë dhe në parandalimin e përjashtimit social do të ishte garancia më e mirë për ruajtjen e sigurisë në qytetet tona. Politikat e menduara mirë për banim social mund të jenë mjete efektive për arritjen e objektivit për kohezion shoqëror dhe për integrim në qytete dhe në zona urbane. Strategjitë e veprimit që janë të përfshira në politikën e zhvillimit të integruar urban, e që konsiderohen shumë të rëndësishme për lagjet e pazhvilluara urbane, janë:

- Vazhdimi i strategjive për përmirësimin e mjedisit fizik
- Fuqizimi i ekonomisë lokale dhe politikës së tregut vendor të punës

- Arsimimi proaktiv dhe politikat e aftësisë për fëmijët dhe të rinjtë
- Promovimi i transportit urban efikas dhe të përbalueshëm

Karta e Lajpcigut thekson se zhvillimi urban duhet të hartohet në nivel shtetëror (kombëtar) dhe duhet të bëhen përpjekje për të gjetur zgjidhje inovative si në nivelin shtetëror ashtu edhe në nivelet e tjera.

Qytetet kanë nevojë të kenë hapësirë të mjaftueshme për veprim për të kryer detyrat lokale në mënyrë të përgjegjshme dhe një bazë të shëndoshë financiare e cila ofron stabilitet afatgjatë. Autoritetet lokale duhet të zhvillojnë aftësitë e nevojshme dhe efikasitetin për zbatimin e politikave për zhvillim të integruar urban, po ashtu me qëllim të arritjes së një cilësie dhe qëndrueshmërie të përgjithshme në mjedisin e ndërtuar.

Në nivel kombëtar, departamentet e qeverisë duhet të njohin më mirë rëndësinë që kanë qytetet në përmbushjen e ambicieve shtetërore, rajonale dhe lokale dhe ndikimin e politikave të tyre në to. Karta thekson rëndësinë e shkëmbimit sistematik dhe të strukturuar të përvojave dhe njohurive në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm urban. Nevojitet një platformë evropiane për grumbullimin dhe zhvillimin e praktikave më të mira, statistikave, studimeve dhe standardeve, vlerësimeve, shqyrtimeve dhe hulumtimeve të tjera për të përkrahur aktorët e përfshirë në zhvillimin urban në të gjitha nivelet dhe sektorët.

Evropa ka nevojë për qytete dhe rajone që janë të fuqishme dhe të mira për të jetuar në to.

Burimi: Karta e Lajpcigut mbi Qytetet e Qëndrueshme Evropiane

SKENARËT HAPËSINOR PËR EVROPËN



Në mesin e shumë raporteve hulumtuese që mund të gjeni dhe shkarkoni nga faqja e internetit të ESPON-it (www.espon.eu), është një që është shumë interesant për "të ardhmen territoriale", me tre skenarë të ndryshëm kontrastues hapësinar për zhvillimin territorial të BE-së. Trendi i skenarit thekson ndikimin e forcave më të rëndësishme shtytëse në kontekstin e një politike praktikisht të pandryshueshme. Në bazë të këtij trendi të skenarit, janë përpunuar dy skenarë mbi politikën. Në njërin, politika është e orientuar drejt përmirësimit të aftësisë konkurruese të Evropës në kontekstin global. Në tjetrin, fokusi i politikës është i orientuar drejt kohezionit, ekonomik, shoqëror dhe territorial.

Krahasimi i rezultateve të këtyre dy skenarëve mbi politikën ofron një vështrim të thellë në efektet dhe kufizimet e secilit kombinim politik në ndikimin e tij në rrugën e zhvillimit territorial të Evropës. Raporti është literaturë shumë e rekomanduar për lexim nga ata që bëjnë dhe që planifikojnë politikat, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. A nuk fillon një plan i mirë lokal me pozicionimin e qytetit/ komunës tuaj në hartën evropiane...?

Për më shumë informata, ju lutem shikoni në http://www.espon.eu/mmp/online/website/content/publications/98/1378/index_EN.html



Mitrovicë
Mitrovica



Peja
Peja

Gjakovë
Djakovica



Prishtinë
Prishtina

Ferizaj
Urusevac



Prizren



Gjiçan
Gnjilane

BASHKË BËJMË QYTETE MË TË MIRA

Për të siguruar një jetë më të mirë për gjithë qytetarët, Kosova ka nevojë për qytete më të mira. Kjo mund të arrihet vetëm përmes planifikimit dhe punës së përbashkët. "Bashkë krijojmë qytete më të mira" është motoja e Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal, financuar nga SIDA, përmes të cilit UN-HABITAT-i do të mbështesë planifikimin komunal hapësinor në Kosovë. Planet duhet të jenë strategjike dhe të orientuara në veprime, detaje në planet rregullative urbane dhe të zbatuara me investime private e publike. Gjashtë qytetet sekondare të Kosovës – Peja, Gjakova, Prizreni, Mitrovica, Ferizaj dhe Gjiçani – mund të kontribuojnë në një zhvillim më të drejtë dhe të sigurt të Kosovës dhe të zvogëlojnë migrimet e vazhdueshme të popullsisë drejt kryeqytetit, Prishtinës. Përmes integritit në rrjetin urban evropian, qytetet dhe qytetarët e Kosovës do të lidhen me qytete tjera evropiane. Kjo mund të arrihet duke tërhequr investimet në zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe duke përmirësuar qasjen për të gjithë. Investimet private janë të nevojshme për t'u kombinuar me ato publike, drejt sigurimit të shërbimeve më të mira për qytetarët: banim të përshtatshëm social, spitale, shkolla, transport publik, rrugë, si dhe përfundimisht, por jo më pak e rëndësishme, hapësirat atraktive publike për t'i kënaqur nevojat e një shoqërie në ndryshim.

IMPRESSUM



UN-HABITAT



Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal
në Kosovë

Udhëheqëse e Zyres
Elisabeth Belpaire
office@unhabitat-kosovo.org

Zyra:
UN-HABITAT Kosovë
Rr: Nazim Gafurri, Nr. 33,
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel.: +381/38/517835
Fax: +381/38/517836

Informimi & Komunikimi/MP
Lumnije Gashi
lumnije.gashi@unhabitat-kosovo.org

Për më shumë informata:
UN-HABITAT/MuSPP

Ky Buletin është mundësuar nga Qeveria e Suedisë përmes SIDA-s. Gjitha vështrimet, mendimet dhe konkludimet i përkasin autorëve. Artikujt pa tregim autori janë pjesë e ekipit të MuSPP-it. Kontributet në lidhje me komunat jo domosdoshmërisht reflektojnë pozitën dhe vendimet e komunave në fjalë. Përmbajtja e këtyre artikujve jo domosdoshmërisht reflektojnë: Qëndrimin e UN-HABITAT-it ndaj çështjeve të ngritura apo deklaratave të bëra, si dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë vështrimet e SIDA-s, apo Qeverisë së Suedisë.